



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit administrativ nr. 05/2021, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe marrëveshjes së mirëkuptimit nr. 01/B -1826 datë 27.03.2023, mes MASHTI dhe Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, MASHTI, shpall:

KONKURS

**Për vendet e punës në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza”
Prizren**

Nr.	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitave
1	<i>Asistent për gjuhën e shenjave në QB “Nënë Tereza” në Prizren</i>	Kohë të caktuar	2

I. Punët dhe detyrat kryesore të Asistentit/es të gjuhës së shenjave

- Drejtpërdrejtë merr pjesë në aktivitete arsimore dhe jashtë arsimore;
- Mbështet nxënësit në klasë në mësimin e gjuhës së shenjave;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre nëse ata kanë nevojë;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim në gjuhën e shenjave dhe pjesëmarrje në lojë;
- Mbështetë nxënësit në punën praktike;
- Bashkëpunon me mësimdhënësit dhe edukatorët në përgatitjen e materialeve në gjuhën e shenjave.

2. Përgatitja shkollore për Instruktor të gjuhës së shenjave

- Arsimi i mesëm
- Certifikatë mbi kryerjen e trajnimit për gjuhën e shenjave me 120 kredi (ECTS).

Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: neni 35 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, paragrafi 9 i nenit 8 të Udhëzimit administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

– Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës.

Informata shtesë

Procedura e konkursit për punësimin e asistenteve në QB “Nënë Tereza” në Prizren, bëhet nga MASHTI, ndërsa pagesa bëhet nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, periudha e angazhimit të asistenteve në QB “Nënë Tereza” në Prizren është 17 muaj dhe pagesa është 416,86 € (pagë bruto në muaj).

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Formulari i aplikimit (merret në Qendrën Burimore ku është konkursi).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës dhe duhet të jenë të noterizuar.

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore/shkollën speciale përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.